

Mr. Vlado P. Lutovac

Samograd

Muzeu Polim Berane, polimskimuzej@t-com.me

Abstrakti: Për shumë vite me radhë, IP Muzeu i Polimles në Berane po kryen kërkime arkeologjike të fortifikatës së Samogradit, e cila ndodhet në fshatin Prijelozi në bashkinë e Bijello Poles. Ky fortifikim unik, pothuajse i fortifikuar natyrshëm, është përdorur për banim që nga epoka e bronzit deri në mesjetë. Në periudhën e deritanishme janë përcaktuar drejtimet e shtrirjes së bedenave, porta kryesore dhe muri që ndan akropolin nga suburbet. Janë eksploruar bazilika extra-muros, e cila gjendet në jug të portës së fortifikatës dhe bazilika intra-muros, e cila gjendet në suburb, porta hyrëse, objektet që mbështeten në pjesën e brendshme të bedenit perëndimor dhe bedeni që ndan akropolin nga suburb. Pothuajse në të gjitha mbetjet e zbuluara arkitekturore janë marrë masat e konservimit, pjesërisht janë mbimurosur dhe është vendosur kupola mbrojtëse.

Fjalët kyçe: bazilika, krishterimi i hershëm, mortariumi, ampula për ujin e shenjtë, kryqi i artë.

Samogradi, ose siç quhet ndryshe Kamenigradi (Lutovac, 1973: 125), ndodhet buz lumit Brzava, rreth 4,5 km në rrjedhën e sipërme të Limit, pothuajse nën vetë masivin e Bjellasicës. Në një lëndinë konike, pjesërisht të mbuluar me pyll të dendur, ngrihet një fortifikim i pazakontë. Bëhet fjalë për një hapësirë prej gjysmë hektari, e kufizuar nga shtatë shkëmbinj të mëdhenj e të lartë, lartësia e të cilëve është nga 30 deri në 80 m. (Fig. 1).

Hapësira midis shkëmbinjve është e mbushur me bedene, gjurmët e të cilëve janë edhe sot të dukshme. Vendasit e moçëm kujtojnë pjesët e ruajtura mirë të mureve rrethues, si dhe muret e brendshme të fortifikimit, i cili ndahet natyrshëm në pllajën e sipërme (50 x 20 m) dhe të poshtme (50 x 70 m), të veçuara nga një lloj nënmuri, i cili është tërësisht i rrënuar.” (Mrkobrad dhe Jovanoviq, 1989: 31).

HISTORIKU I KËRKIMEVE ARKEOLOGJIKE

Gërmimet e para arkeologjike sondazhuese në Samograd u kryen gjatë vitit 1988 (Mrkobrad dhe Jovanoviq, 1989: 31-46) dhe vitit 1989 (Mrkobrad dhe Lutovac, 1990: 135-139) nga Qendra për Kërkime Arkeologjike e Fakultetit Filozofik në Beograd, në bashkëpunim me Muzeun e Polimles në Berane, dhe Muzeun e Bijello Poles. Me atë rast u hapën katër sonda testuese dhe një vijë-kanal testues. Sonda 1 është vendosur përgjatë anës së brendshme të bedenit jugperëndimor të suburbit, në pllajën e poshtme; sonda 2 përgjatë anës së brendshme të bedenit verior në pllajën e sipërme; sonda 3 rreth 70 metra para Samogradit (në pjesën perëndimore të hyrjes); sonda 4 përgjatë bedenit lindor në pllajën e poshtme dhe Vijë-kanali A në zonën e objektit sakral që ndodhet jashtë fortifikimit (bazilika extra-muros). Në fushatën e dytë, të zhvilluar gjatë vitit 1989, u zbulua naosi i *bazilikës intra-muros* dhe pjesërisht u hulumtua naosi i *bazilikës extra-muros* (Lutovac, 2009: 245-256).

Muzeu i Polimles në Berane nisi kërkimet arkeologjike sondazhuese në vitin 2010, në zonën e portës së qytetit e cila ndodhet në anën perëndimore, pothuajse në skajin më të lartë në anën veriore të suburbit. Pas kërkimeve, mbetjet e portës u konservuan dhe u ngritën në një lartësi prej rreth 3,50 m.

Gërmimet sistematike arkeologjike, Muzeu i Polimles ndërmerr në vitin 2014, kur në tërësi u hulumtua *bazilika extra-muros*. Kjo hapësirë u kategorizua si Sektori I, dhe gërmimet u kryen përmes një rrjeti katror me kuadrate, me përmasa

4 x 4 metra. Asokohe u zbuluan të gjitha mbetjet e mureve të bazilikës, kurse naosi u zbraz deri në nivelin e dyshemesë. Gjatë vitit 2017 janë ndërmarrë gërmime sistematike arkeologjike të bazilikës *intra-muros*, në zonën e kategorizuar si Sektori III, dhe janë vazhduar gërmimet në *bazilikën extra-muros*, me qëllim mënjanimin e nekropolit mesjetar nga naosi i bazilikës. Në këtë fushatë, është kryer sondazhi i nekropolit jugor paleokristian me tre sonda testuese. Zona e nekropolit është shënuar dhe veçuar në Sektorin II. Në fushatën e organizuar në vitin 2018, janë ndërmarrë masat konservuese në muret e zbuluara të *bazilikës intra-muros* dhe filluan gërmimet sistematike arkeologjike të mbetjeve të objekteve të mbështetur në anët e brendshme të bedenave jugperëndimore – në suburbe (Sektorin IV). Gjatë vitit 2019 u hapën dy kuadratë, me përmasa 4 x 4 metra para hyrjes në *bazilikën intra-muros*, për një vëzhgim të detajuar të shtresave stratigrafike të Samogradit. Krahas këtyre gërmimeve, u zbuluan mbetjet e bedenave që ndanin akropolin nga suburbia, si dhe u kryen masa konservimi të mbetjeve të objekteve banuese të zbuluara në suburban, në anën e brendshme të bedenit jugperëndimor.

ARKITEKTURA MBROJTËSE

Brenda kodrinës shkëmbore konike, e cila ngrihet mbi shpatet pjellore dhe të buta të bregut të majtë të lumit Ruishka, u ngrit një fortifikatë antike, e më pas vizantike e hershme (Fig. 2).

Bëhet fjalë për një hapësirë me sipërfaqe prej gjysmë hektari, e rrethuar nga shtatë shkëmbinj të mëdhenj e të lartë, me lartësi nga 30 deri në 80 metra. Hapësira midis tyre është e ndërlidhur me bedene të fuqishme, gjurmët e të cilëve janë të dukshëm edhe sot. Hapësira e brendshme ndahet natyrshëm në dy pjesë, në pllajën e sipërme dhe më të vogël në pjesën veriore, dhe pllajën pak më të madhe dhe më të ulët në anën jugore dhe jugperëndimore. Diferenca në lartësi midis këtyre pllajave është rreth 10 m. Në bazë të kërkimeve të deritashme arkeologjike, janë veçuar qartë dy faza ndërtimi, në bedena dhe në objektet e zbuluara.

Në fazën e parë të ndërtimit, u ngrit fortifikimi me ndërtimin e bedenave, me gjerësi 1,40 m, ndërmjet grupeve të shkëmbinjve të thepisur në pllajën e sipërme dhe të poshtme. Mbetjet e këtij

bedeni u zbuluan në sondat I dhe II, të hapura në vitin 1987, si dhe në Sektorin II gjatë gërmimeve të kryera në vitin 2018. Bedenat e kësaj periudhe ishin bërë me blloqe katrore të çrregullta, të renditur në rreshta të drejtë horizontale dhe të lidhur me suva gëlqereje. Muret shtrihen përgjatë rrëpirave, nga njëri shkëmb në tjetrin, duke mbyllur kështu hapësirën e brendshme të fortifikimit. Nuk kemi të dhëna për një portë eventuale, por në bazë të konfigurimit të terrenit mund të supozohet se ajo të ketë qenë integruar në bedena gjatë ndonjë rinovimi të mëvonshëm (Fig. 2).

Në fazën e dytë të ndërtimit u ngritën bedena të rinj me gjerësi 1,70 m në pllajën e poshtme dhe 1,40 m në pllajën e sipërme. Janë punuar me të njëjtën teknikë si muri i vjetër rrethues, përveç se blloqet e gurit janë gdhendur më me pak vëmendje, janë mjaft të çrregullt, me vetëm një faqe të punuar me kujdes. Gjatë kësaj periudhe, u ngrit edhe bedeni që ndan akropolin nga suburbia. Ky mur ndarës është 1,60 m i gjerë dhe është ndërtuar në një rrëpirë, pak nën rrafshin e pllajës së sipërme. Është punuar me të njëjtën teknikë si bedeni perëndimor dhe është ruajtur në lartësinë prej rreth 1.50 m. Muri që ndan akropolin nga suburbia fillon nga një shkëmb i pjerrët në anën lindore (mu mbi *bazilikën intra-muros*) dhe shtrihet në perëndim me një gjatësi rreth 27,90 metra (Fig. 2). Në afërsi të shkëmbit në anën perëndimore ishte lënë një kalim i ngushtë për në akropol, rreth 1 metër i gjerë. Kalimi është lart në murin e bedenit, ndaj me siguri duhet të ketë ekzistuar një platformë ose shkallë për akses më të lehtë. Meqë është ndërtuar në një të pjerrët drejt rrafshit të poshtëm, bedeni u përforcua me mbështetëse kundërforcë 18 m të gjatë dhe 0,40 m të gjerë.

Porta e fortifikatës u zbulua në anën perëndimore të suburbanit, në muret jugperëndimore, pothuajse fare buz shkëmbit të pjerrët që ndodhet në anën veriore (Fig. 2). Ajo përbëhet nga kalimi me gjerësi 2,95 metra dhe një mur mbrojtës i ngritur përpara hyrjes. Në hyrje kishte një portë prej druri, dykrahëshe, siç dëshmojnë gjetjet e gozhdave të mëdha, me kokë të gjerë katrore, me të cilat ndryhej. Hyrja ishte e fshehur dhe e mbrojtur nga një mur i ndarë, i ngritur para portës, në një distancë prej rreth 7 m. Ky mur ndarës mbështetej në skajin e pjerrët i cili gjendet në anën veriore dhe i cili shtrihet drejt jugut në gjatësi rreth 6 metra. Pjesa e jashtme e bedenit jugperëndimor, nga porta

hyrëse drejt jugut, është zbuluar në një gjatësi rreth 65 m, dhe është ruajtur në lartësinë nga 2,10 m në veri, deri në 1,50 m në jug.

OBJEKTET SAKRALE

Bazilika extra-muros

Mbetjet arkitektonike të kësaj bazilike ndodhen rreth 50 m në jug të portës së fortifikatës, pothuajse poshtë bedenit jugperëndimor (Fig. 3/1). Në të dallohen qartë dy faza ndërtimi (Fig. 4).

Fillimisht u ndërtua një bazilikë njënefshe paleokristine, me një absidë të thellë gjysmërrëthore në anën verilindore dhe një hyrje, 1,40 m të gjerë, në anën jugperëndimore. Është 21 metra e gjatë dhe 8 metra e gjerë. Në bazilikë ekzistonin edhe dy hyrje të tjera. Njëra në veriperëndim, me gjerësi 0,80 m dhe tjetra në juglindje, me gjerësi 0,95 m. Hyrjet anësore janë më afër krahëve të brendshme të absidës. Përgjatë murit veriperëndimor të bazilikës, në linjë me fasadën perëndimore, u ngrit njëkohësisht një pagëzore (piscina) katrore, me përmasa 3,55 x 3,45 m.

Muret e bazilikës dhe të pagëzores, me gjerësi 0,65 - 0,70 m, janë ndërtuar me blloqe guri të papunuar ose të gdhendur, të vendosur në rreshta mjaft të rregullt horizontal, të ngjitur me llaç gëlqereje. Dyshemeja e bazilikës është prej guri të grimcuar në suva të shkrirë, me trashësi 0,10 m dhe është e lyer me suva të kuqe rezistente ndaj ujit. Dyshemeja dhe suvaja në muret e piscinës janë bërë me të njëjtën suva të kuqe rezistente ndaj ujit. Nga të dhënat e fituara në terren, mund të themi me bindje se kornizat e theksuara të dyerve të hyrjes veriperëndimore dhe asaj juglindore të naosit të bazilikës janë punuar me suva rezistente ndaj ujit.

Në fazën e dytë të ndërtimit, bazilika u shkurtua 4 metra në anën perëndimore, kurse në anën juglindore u shtua një aneks për nevoja funerale (Fig. 4 / 2,3a). Ky aneks është 4 m i gjerë dhe 15,60 m i gjatë. Me dy mure tërthore, pjesa e brendshme e aneksit ndahet në tre hapësira të lidhura me kalime të lëna përgjatë murit jugor të bazilikës. Dy hapësirat fundore (verilindore dhe jugperëndimore) kanë pothuajse të njëjtën gjatësi: 3,65 dhe 3,50 m, ndërsa ajo qendrore është më e madhe dhe është e gjatë 6,40 m. Në hapësirën qendrore, përgjatë murit jugor të bazilikës (pas murosjes së hyrjes anësore të naosit), u ngrit një varr mbitokësor, me

përmasa 2,80 x 1,65 m. Në lartësinë 0,70 m nga dyshemeja prej suvaje, brenda varrit është ngritur një katafalk për varrime, ndërsa përgjatë anës juglindore shtrihet një kanal për kullimin e mbetjeve organike (Fig. 5). Hapësira për shtrimin e të vdekurit, kanali i formuar dhe muret e brendshme kanë qenë të suvatuar me suva të kuqe rezistente ndaj ujit. Gropa e varrit ndodhej në anën verilindore dhe prej saj është ruajtur shtalka e derës lindore, e punuar me blloqe grushtupi gëlqeror dhe një brazdë për vendosjen e pllakës së gurit që mbyllte varrin.

Në katafalk, brenda varrit, u gjetën mbetjet osteologjike të tre të vdekurve të varrosur (Fig. 5). Tek i vdekuri, i cili zinte hapësirën qendrore, u gjet një varëse floriri në formë kryqi (T. I / 6) dhe një tel ari i lakuar në formën e paraqitjes së stilizuar të një shkopi (T. I / 7).

Në fazën e dytë të ndërtimit, në absidë u ngrit një *sintronus* me një vend qendror të ngritur, i cili kishte funksionin e katedrës peshkopale (episkopalis). Në atë kohë u bënë riparime të dyshemesë në hapësirën përreth krahëve të brendshme të naosit dhe në absidë. Hapësira përreth objekteve, të ndërtuar në fazën e dytë të ndërtimit, është e mbushur me dhe argjilore të verdhë gurë të thërrmuar imët. Kjo shtresë, me një trashësi mesatare prej 7 deri në 10 cm, paraqet edhe kufirin kronologjik ndërmjet dy fazave të ndërtimit. Pas kryerjes së gërmimeve arkeologjike, në mbetjet arkitekturore të bazilikës *extra-muros*, u ndërmorën masa konservimi me mbimurosjen e pjesshme të disa mureve dhe u formuan kupolat mbrojtëse (Fig. 6).

Bazilika intra-muros

Mbetjet e kësaj bazilike ndodhen në suburbia, në skajin më lindor dhe janë të vendosura ndërmjet dy shkëmbinjve që përfaqësonin kullat mbrojtëse natyrore. Edhe në këtë objekt veçohen qartë dy faza ndërtimi.

Fillimisht u ndërtua një bazilikë, me përmasa 15 x 8,50 m, me absidë në lindje dhe tri hyrje në perëndim (Fig. 7). Hyrja qendrore është 1,40 m e gjerë, ndërsa hyrjet anësore janë më të ngushta dhe pothuajse kanë të njëjtën gjerësi, rreth 1 m. Në bazë të kësaj hyrjeje të trefishtë, mund të supozojmë se bazilika mund të ishte trenefshe, mirëpo gjatë gërmimeve nuk kishim prova materiale që do të konfirmuar një konstatim të tillë.

Në bazilikë, në murin jugor, më afër absidës ekziston edhe një kalim, i cili çonte në një hapësirë

më të vogël të formuar midis murit të bazilikës, bedenit lindor dhe rrëpirës në anën jugore. Bazilika është ndërtuar me blloqe guri të mëdhenj, të gdhendur, të renditur në rreshta horizontal mjaft të rregullt, të ngjitur me llaç gëlqereje. Në disa vende dallohen qartë rreshtat e nivelimit, të punuar me pllaka guri më të holla, të cilat shërbenin për korrigjimin e rreshtave të çrregullt të blloqeve prej guri. Muret e bazilikës kanë gjerësi 0,70 m dhe janë ruajtur në lartësinë nga 0,50 m në lindje, deri në 1,50 m në perëndim. Për shkak të ndikimeve tektonike dhe rrëshqitjes së bedenit lindor, absida dhe krahu jugor i kishës u shembën pjesërisht dhe “rrëshqitën” anës kodrës. Në dyshemenë prej suvaje të bazilikës duken qartë çarjet e tërthorta, të cilat tregojnë lëvizjen e pjesëve lindore të objektit. Dyshemeja e kishës është me suva të kuqe, rezistente ndaj ujit, ndërsa muret e brendshëm janë të niveluar me një shtresë gëlqereje të bardhë. Muri i jashtëm ka fuga të bëra me suva të bardhë.

Në fazën e dytë të ndërtimit, në anën perëndimore të bazilikës, u shtua një narteks i gjerë 10 m dhe i gjatë 5 m. Muri jugor i narteksit përputhet me drejtimin e murit jugor të bazilikës, ndërsa në anën veriore narteksi është më i gjerë se naosi dhe zë të gjithë hapësirën e dobishme drejt rrëpirës veriore. Hyrja në narteks është përafërsisht në aksin e hyrjes qendrore në naosin e bazilikës dhe ka të njëjtën gjerësi (1,40 m). Përgjatë murit jugor të narteksit u ngrit një varr mbitokësor, i ngjashëm me atë të zbuluar në aneksin e *bazilikës extra-muros*. Ndryshimi është se katafalku i varrimit në *bazilikën intra-muros* është në nivelin e dyshemesë së narteksit, kurse në bazilikën *extra muros* është e ngritur. Ky varr u gjet i shkatërruar dhe në të u gjetën mbetjet e dislokuara osteologjike të një personi të moshuar dhe të një të riu.

Në hapësirën e varrit dhe në pjesën jugore të narteksit, dyshemeja është e mbuluar me suva të kuqe, rezistente ndaj ujit. Kjo sipërfaqe dyshemeje shtrihet në veri dhe përfundon në rrafsh me vijën e kornizave veriore të dyerve të narteksit dhe të naosit. Në pjesën e mbetur veriore të narteksit, dyshemeja është nga tokë e ngjeshur argjilore ngjyrë kuqe. Me të drejtë mund të supozohet se në pjesën veriore të narteksit ekzistonte një *protezis* i cili ndahej nga kalimi në naos me një barrierë të lehtë prej druri. Për qëllimin e kësaj hapësire tregojnë edhe gjetjet arkeologjike, nga të cilat spikat gjetja e mortariumit (T. III / 3).

Në fazën e dytë të ndërtimit, në naosin e bazilikës janë bërë riparime të caktuara. U mbyll hyrja veriore në mënyrë që në naos hyhej përmes kalimit qendror, kurse ajo jugore mundësonte aksesin funksional të varrit. Në brendësinë e mureve gjatësore të naosit dhe në anën perëndimore është ngritur një stol muri, me gjerësi 0,27 m dhe lartësi 0,60 m, ndërsa në absidë është ngritur një *sintronus*. Të gjitha dyshemetë dhe stolat janë të veshur me suva të kuqe, rezistente ndaj ujit, ndërsa muret e brendshme janë të niveluar me suva të bardhë gëlqereje. Diferenca në lartësi ndërmjet naosit dhe narteksit, në kalimin qendror, u zgjidh duke ndërtuar dy shkallë, të veshura me terrakotë. Mund të supozojmë se hapësira në të cilën hyhej nga dera jugore, dikur, ishte një pastofori në të cilin, në dheun ndërtimor, u gjet një bravë, pjesë e një arke (TI/10), një enë e vogël qelqi (T.III/ 2) dhe ampulë plumbi për ujë të shenjtë ose mirrë (T. I / 11,11a). Edhe në këtë objekt u ndërmorën masa konservuese. Hapësira e absidës është e siguruar në mënyrë statike dhe e mbimurosur në nivelin e mureve të mbetura të bazilikës.

OBJEKTET BANUESE

Në gërmimet e deritanishme arkeologjike është zbuluar një pjesë e një objekti në pllajën e sipërme dhe pjesë të objekteve të mbështetura në anën e brendshme të bedenit jugperëndimor.

Objektet e zbuluara ndodhen në lartësinë e absidës së bazilikës *extra-muros*, rreth 45 m në jug të portës së fortifikatës. Ato shtrihen përgjatë bedenit të brendshëm në një sipërfaqe prej rreth 85 metrash katrorë. Në këtë zonë u zbuluan mbetje të një bedeni më të vjetër dhe mbetje objekteve të mbështetura pas tyre. Dimensionet e objektit janë 12 x 7 m. Është bërë në të njëjtën teknikë si bedeni, me blloqe të gdhendur e të stivuar në rreshta horizontal mjaft të rregullt, të ngjitur me llaç gëlqereje. Gjerësia e mureve është 0,65 m dhe janë ruajtur në lartësinë nga 0,50 deri në 0,70 m. Mund të supozohet se në fazën e dytë të ndërtimit, gjatë ndërtimit të bedenit të ri, ky objekt është rinovuar, pjesë e të cilit ka mbetur një pjesë e bedenit fillestar, të mbështetur në faqen e brendshme të bedenit nga faza e dytë e ndërtimit. Mbi këtë objekt, në një periudhë të mëvonshme, u ngrit një objekt më i vogël, me përmasa 5,50 x 6,20 m, me mure 0,70 m të gjerë. Përgjatë murit jugor të këtij objekti dhe afërsisht 7 m në veri të tij, u ngritën dy mure

paralele të ndara, pingul me drejtimin e bedenave. Këto mure janë paksa më të trashë dhe nga bedeni shtrihen në hapësirën suburbane në një gjatësi prej 7,50 m. Ndryshe nga ndërtesat e vjetra ku përdorej material lidhës prej gëlqereje, në këtë fazë objektet ndërtoheshin me gurë të gdhendur, të ngjitur me argjilë të kuqërremtë dhe të përzier me gurë të thërrmuar. Objekti i sapondërtuar, brenda hapësirës së rrethuar nga dy mure, i përket mesjetës së vonë dhe me siguri përfaqëson një vathë ose stallë.

STRATIGRAFIA

Bazuar në gërmimet e deritanishme, me analizën e materialit të luajtshtëm arkeologjik dhe me kombinimin e përfundimeve të dala në bazë të elementeve të fortifikimit dhe arkitekturës sakrale, mund të veçohen 4 horizonte të jetesës në këtë fortifikatë:

I - i përket periudhave parahistorike (epoka e bronzit dhe e hekurit),

II - periudha nga formimi i fortifikatës (mesi i shekullit II pas Krishtit) deri në kohën e shkatërrimit (në mes ose në gjysmën e dytë të shekullit III pas Krishtit)

III - periudha e rindërtimit të fortifikatës në shekullin IV deri në braktisjen e fortifikimit në mesin e shekullit V.

IV - Periudha e ripërdorimit të fortifikatës në shekullin VI deri në shembjen përfundimtare në fillim të shekullit VII.

Lëndë e këtij studimi është fortifikata e antikitetit të vonë dhe krishterimit të hershëm në Samograd, mirëpo duhet theksuar se rëndësia strategjike e kësaj strehe (*refugium*) natyrore është vërejtur që në parahistori. Në mesin e shekullit II dhe fillimin e shekullit III, në Samograd u ngrit fortifikata e parë e muros. Kësaj periudhe i përket bedenat, me gjerësi 1,40 m, të ndërtuar përgjatë rrëpirave në pllajën e poshtme dhe të sipërme. (Mrkobrad dhe Jovanović, 1989: 43, T. II /1-3). Fortifikata u rrënua në gjysmën e dytë të shekullit III dhe nuk dihet arsyeja e drejtpërdrejtë e shkatërrimit të saj. Megjithatë, nga tabloja e përgjithshme e ngjarjeve në zonat fqinje, mund të bëjmë një supozim të bazuar në mbetjet e regjistruara të monedhave nga koha e shkretimit të krahinave të atëhershme fqinje, Dalmacisë dhe Dardanisë, në periudhën nga viti 230 deri në vitin 260 pas Krishtit (Mrkobrad dhe Jovanović, 1989: 43; Mirnik, 1981: kat.br. 149, 157, 195, 231). Një

sulm barbar, me gjasë gotik, mund të gjurmohet nga Ponishavla (Ponišavlja), nëpër Kosovë e deri në Nikshiq. Mund të supozohet se gjatë rrugës së tyre hasën edhe Polimlen dhe atëherë rrënuan dhe plaçkiten të gjitha fortifikimet në të.

Në bazë të materialit qeramik dhe monedhave të gjetura prej bronzit, mund të pohojmë me bindje se fortifikimi është rindërtuar në shekullin IV, në kuadër të rimëkëmbjes së organizuar të fortifikimeve në kohën e Dioklecianit ose Konstandinit I (Mrkobrad dhe Jovanović, 1989: 43, T. III dhe IV). Nga rreth dhjetë monedha të gjetura prej bronzit, pesë janë të ruajtura mirë dhe të dallueshme. Dy monedha i përkasin Konstandinit I (306-337), kurse nga një Konstancit II (324-361), Valensit (364-378) dhe Valentinianit I (364-375). Në këtë periudhë u ndërtuan bedenat me gjerësi 1,70 m në pllajën e poshtme dhe 1,40 m në pllajën e sipërme. Asokohe, akropoli ndahej nga suburbii (varoshi) me një beden 1.60 m të gjerë. Në anën jugperëndimore është ndërtuar një portë e re dhe mund të supozohet se në vete ka integruar atë nga faza e mëparshme e ndërtimit. Për këtë periudhë të jetesës në Samograd mund të lidhim ndërtimin e bazilikës *extra-muros* (bazilika njëeëfshe me piscinë në anën veriore) dhe ndërtimin e bazilikës *intra-muros* (bazilika me tre hyrje). Në bazë të materialit të disponueshëm, mund të themi se fortifikata u përdor deri në mesin e shekullit V. Arsyeja e braktisjes së kësaj fortifikate nuk dihet.

Fortifikata u përdor dhe u rindërtua përsëri në shekullin V, në kuadër të ringjalljes së perandorisë së Justinianit (Mirković, 1978: 1-8; Nikolajević, 1976: 202, etj.). Me bindje mund të pohojmë se kësaj periudhe i përket shtesat në të dyja bazilikat. Bazilika *extra-muros* u shkurtua 4 metra në anën jugperëndimore, u rrënua pagëzorja, kurse në anën juglindore u shtua një aneks për nevoja funerale. Brenda bazilikës në pjesën e përparme të sintronosit (*syntronos*), në aksin e absidës, u ngrit një katedër e veçantë peshkopale. Bazilikës *intra-muros* iu mbimuros një narteks me varr memorial dhe stola (*supselia*) në brendësi të naosit, kurse në absidë u ngrit një sintronos. Kësaj periudhe i takojnë numri më i madh i objekteve metalike të gjetura në Samograd, si dhe një pjesë e materialit qeramikë që është veçuar dhe përcaktuar kronologjikisht gjatë gërmimeve të para arkeologjike (Mrkobrad dhe Jovanović, 1989: 42, T. V / 1-7). Fortifikata u shkatërrua në fillimin e shekullit VII.

GJETJET

Deri më tani, mbi 500 sende që i përkasin periudhave të ndryshme të jetesës janë gjetur në këtë strehë (*refugium*) natyrore, e cila më pas u fortifikua dhe u kthye në një fortifikim të pazakontë. Nga gjetjet arkeologjike që i përkasin antikitetit të vonë dhe krishterimit të hershëm (paleokrishterimit), janë veçuar sendet që në mënyrën më të mirë përfaqësojnë gjendjen ekonomike dhe shpirtërore të fortifikatës së ndërtuar në Samograd.

Fragment ene

Argjilë, e punuar në çikrik, pjekje; dimensionet: 8,4 x 5,3 x 0,5 cm; Bazilika *extra-muros*, Sektori I - Kv. C5 / 1.o.s; Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet në gjysmën e dytë të shekullit IV dhe shekullin V.

Fragment i një ene me dorëz të rrumbullakosur, qark thujse të sheshtë dhe të kthyer, të prerë vertikalisht nga jashtë, prej argjile me miksturë rëre, me përpunim të vrazhdë dhe baltë okër të çeltë (T. I / 1). Analogjitë më të afërta për këtë lloj ene mund të gjenden në lokalitetin Ras-Pazarishtë (Ras-Pazariste), afër Novi Pazarit dhe në Vrsenicë (Vrsenica) afër Sjenicës (Sjenica).

Analogjitë: Popović, 1999: 95, T. 46/11; Popović i Bikić, 2009: 60, sl. 40/2).

Kopsë

Hekur, farkëtim, lakim: dimensionet: 2,2 x 0,3 cm; Katror: Kvadrat: B1 / Pov.o. s.;

Muzeu i Polimles në Berane

Datohet në shekullin IV

Kopsë e vogël brezi "omega" (Sagadin, 1979: 306-307), në formë rrethore, me qarkun e përthyer në volute që janë pingul me trupin (Pl. III / 12). Trupi i kopsës me prerje katrore, mungon thumbi për mbërthim. Kopsa të ngjashëm u gjetën në Tumbarice, Šarski krš (Šarskom kršu) pranë Duga Polana (Duge Poljane) dhe në kështjellën Ras afër Novi Pazarit dhe ato mund të hasen pothuajse në të gjitha vendet e antikitetit të vonë dhe krishterimit të hershëm.

Analogjitë: Popović, 1983: 10-11; Popović, 1999: 111, kat.br. 81, sl.58/21.

Fragment ene

Argjilë, e punuar në çikrik, pjekje: dimensionet: 7,4 x 4,3 x 0,5 cm. E gjetur në afërsi të extre-muros, Sektori I - Kv. BIII / 3.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane

Datohet në gjysmën e dytë të shekullit VI dhe gjysmën e parë të shekullit VII

Enë e thellë, me formë të lehtë koni, me qark të kthyer dhe të pjerrët, e punuar nga argjila me miksturë rëre, balta ka ngjyrë të errët (T. I/2). Ekzemplarë të ngjashëm janë gjetur në Gradina Vrsenica pranë Sjenicës dhe në lokalitetin Ras-Pazarishtë, afër Novi Pazarit.

Analogjitë: Popović i Bikić, 2009: 72, sl.49/2; Popović, 1999: 95, sl. 46/8.

Fragment ene

Argjilë, e punuar në çikrik, pjekje: dimensionet: 7,4 x 6,9 x 1 cm. bazilika extre-muros, Sektori I / Kv. E 6/6.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane

Datohet në gjysmën e dytë të shekullit IV dhe gjysmën e parë të shekullit V

Fragment ene, në formë gjysmësphere, me qafë horizontale pakëz të hapur, e punuar nga argjila me rërë, balta ka ngjyrë gri, me sipërfaqe verniku ngjyrë gjelbër ulliri (T. I/3). Ekzemplarë pothuajse të njëjtë janë gjetur në Qupri (Ćuprija) dhe në lokalitetin Ras-Pazarishtë, afër Novi Pazarit.

Analogjitë: Popović, 1999: 310, T. I / 12, fig. 52/3,4.

Fragment shtambe

Argjilë, e punuar në çikrik, pjekje, vernik: gjatësia 6 cm, gjerësia 2,6 cm, trashësia 1,7 cm. Bazilika extra-muros (Sektor I / Profil E1-F4); Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet në shekujt V-VI.

Fragment i dorëzës së shtambës, me vernik të verdhë në të gjelbër (T. I/4). Dorëza është stolisur me ornamentin në formë katrori, në tre rreshta vertikale. Ornamentet katrore janë të pjerrëta, me kënd 45° dhe formojnë brinjë vertikale zigzag. Ekzemplari identik është zbuluar në Kastel Dijana në Limesin e Gjerdapit (Đerdapskom Limesu).

Analogjitë: Cvjetičanin, 2006: 98.

Fragment i llambës

Argjilë, e punuar në çikrik, pjekje, vernik: lartësia e ruajtur 10 cm; në anën e jashtme të murit jugor të aneksit për varrosje. Sektori I / Kv. F2/3.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet nga shekulli IV deri në shekullin VI

Tre fragmente të bazamentit të llambës, në mbajtësen cilindrike dhe të profilizuar, të punuar nga argjila me miksturë guri, baltë ngjyrë kuqe. Sipërfaqja e lyer me vernik të verdhë në të gjelbër (T. I/5). Kjo lloj llambe është gjetje relativisht e shpeshtë në lokalitetet paleokristiane. Ekzemplarë të ngjashëm janë gjetur në lokalitetet përgjatë limesit të Danubit: Dijana, Mihajlovac, Mora Vage, si dhe në lokalitetin Gamzigrad pranë Negotinit.

Analogjitë: Špehar, 2010: 94; Tomović, 1986, 40, fig.24; Cermanović – Kuzmanović i Stanković, 1986: fig. 8/3; Cvjetičanin, 2006: 105, sl.9, KAGS 10a.

Kryq

Ar, i shkrirë, farkëtim, granulim: lartësia 3 cm, gjerësia 1,6 cm, trashësia 0,4 cm. Në skeletin qendror të varrit i cili gjendet në aneksin jugor të bazilikës extra-muros. Sektori I / Kv. E3-E4/ 2.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet në periudhën nga shekulli V deri në shekullin VII.

Varëse në formë kryqi, e punuar nga një fletë e hollë ari me qark të zgjeruar, e llojit latin (T. I/6). Në pjesën qendrore është i vendosur një gur i kuq, gjysmë i çmuar, me shumë gjasë almadin. Pjesa qendrore është e stolisur me një sërë granulash të vogla ari. Pjesa e pasme e kryqit është e lëmuar. Në pjesën e sipërme është një hallkë e gjerë dhe rrethore për kalimin e zinxhirit. Theksohen tri vija paralele.

Analogjitë: Ekzemplarë i ngjashëm ekziston në katalogun e ekspozitës së muzeut në Mynih (Begleitbuch zur Ausstellung, 2004/2005: 311, pub. 526).

Varëse

Ar, shkrirje; lartësia 2,2 cm; Në skeletin qendror të varrit i cili gjendet në aneksin jugor të bazilikës extra-muros Sektori I / Kv. E3-E4/ 2.o.s.; Muzeu i Polimles në Beranë.

Datohet nga shekulli V deri në shekullin VII

Varësja është punuar nga teli prej ari, me prerje të rrumbullakosur, në formë shkopi, me pjesën e pasme të lakuar për kapje në zinxhir ose në rroba (T. I/7). U gjet me kryqin tashmë të shpjeguar.

Pllakë stolisëse - kopsë

Bronz, shkrirje, gërvishtje, thumbim; lartësia 4 cm, gjerësia 3 cm; bazilika extra-muros, Sektori I / Kv. B5/pjesa e zgjeruar; Muzeu i Polimles në Berane

Datimi: shekulli VI

Pllaka stolisëse prej bronzi me formë kënddrejte, me çelje të theksuara dhe të nxjerra për përforsim. Në çelje u ruajtën thumba të vegjël prej bronzi. Pllaka është e stolisur në trajtë zonale, me motive të gërvishtje dhe të thumbuara (T. I/8). Ka mundësi se bëhet fjalë për një pjesë të kopsës së brezit.

Zinxhir (varëse fyt) i polielejit (polyeleos)

Bronz, shkrirje, farkëtim; gjatësia 7,5 cm; bazilika extra-muros, Sektori I Kv. B3/3.o.s.;

Muzeu i Polimles në Berane

Në bazë të kushteve të gjetjes, datohet nga fundi i shekullit VI ose gjysma e parë e shekullit VII.

Zinxhir bronzi, me gjatësi 7,5 cm, me hallka të kthyera në formën e numrit tetë, i cili përfundon me grremç diç më të madh (T. I/9). Me gjasë bëhet fjalë për zinxhirin i cili mbante llambën ose polielejin.

Dry

Bronz, hekur, farkëtim, stampim; lartësia 5,1 cm, gjerësia 4,2 cm, trashësia me dry 1,2 cm; në anën e jashtme të portës jugore të bazilikës intra-muros, Sektori III/ Kv. G1/3.os;

Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet nga fundi i shekullit VI dhe gjysma e parë e shekullit VII

Dry i vogël prej çeliku me pllakën stolisëse, në formë katrore dhe prej bronzi në anën e përparme (T. I/10). Rreth çeljes për çelës stolisja është bërë duke stampuar rrethin me pikë. Në pjesën e poshtme mbyllësja e bravës, prej bronzi.

Ampulë

Plumb – kallaj, shkrirje; lartësia 8,4 cm, gjerësia e recipientit 6,2 cm, trashësia e recipientit 2,2 cm; në anën e jashtme të portës jugore të bazilikës intra-muros, Sektori III/ Kv. GI/3.os – Muzeu i Polimles në Berane.

Në bazë të vendgjetjes, datohet në fundin e shekullit VI dhe gjysmën e parë të shekullit VII.

Ampulë për Mirrën e Shenjtë ose Ujin e Bekuar, e bërë nga një legurë plumbi dhe kallaji, me një qafë cilindrike të rrumbullakosur dhe recipient rrethor e të sheshtë (T. I/11). Në qafën e ampulës është një stoli në formën e dy kryqeve të vendosura përballë njëri tjetrit, ndërsa në trupin e ampulës, në të dy anët, në pjesën qendrore gjendet rozeta ose kristogrami rreth së cilës janë renditur motive gjeometrike dhe vegjetale në rrathë të veçuara. Krijohet përshtypja se të dyja anët e ampulës janë bërë në të njëjtin kallëp dhe më pas janë bashkuar.

Shigjetëz

Hekur, farkëtim; gjatësia 5,2 cm; në lindje të portës jugore të bazilikës intra-muros; Sektori III/ kv. FII/2.os ; Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet në shekullin VI dhe gjysmën e parë të shekullit VII (Popović, 1999: 113,sl.59/4).

Shigjetëz prej hekuri me tre tehe, me gjemb të shkurtër (T. II / 1). Kjo lloj shigjetëze është me origjinë aziatike dhe erdhi në krahinën tonë gjatë dyndjeve të popujve. Kishin përdorim të gjerë tek avarët dhe janë relativisht të zakonshme në sitet gepide në Panoni. Padyshim përdorëshin edhe nga ekuipazhet romane. U gjetën në vendet përgjatë limesit të Danubit, por edhe në Caričin grad (Caričin grad).

Analogjitë: Kovačević, 1977: 119; Mrkobrad, 1980: T. LXXXI /11-13; Špehar, 2010:134, kat.br. 696-708, T. XXXIX /696,698,703,704,708; Kondić i Popović, 1977: 212, T. XXVIII/102.

Shigjetëz

Hekur, farkëtim; gjatësia 5,7 cm, gjerësia e gjethit 1,5 cm; bazilika intra-muros, Sektori III/ Kv. C1/2.os; Muzeu i Polimles në Berane

Datohet në fundin e shekullit VI dhe fillimin e shekullit VII

Gjethi i shkurtë dhe i gjerë i shigjetëzës prej hekuri në formën e trapezit me gjemb (T. II/2). Si ajo e shpjeguar më lartë. Këto lloj shigjetëzash, në aspektin tipologjik dhe kronologjik, janë dukuri me jetëgjatësi, prandaj duhet të datohen sipas kontekstit stratigrafik të cilit i përkasin.

Analogjitë: Popović i Bikić, 2009: 81, sl. 57/5.

Monedhë

Bronz, farkëtim; dimensionet 1,8 x 0,1 cm; bazilika intra-muros, Sektori II/ Kv: BI/1.o.s.; Muzeu i Polimles – Berane

Constantin I (306-337), (T.II/3,3a).

Monedhë

Bronz, farkëtim; dimensionet 1,5 x 0,1 cm; Para hyrjes në bazilikën intra-muros, Sektori II/ Kv: BI/1.o.s.; Muzeu i Polimles – Berane

Constantin I (306-337), (T.II/6,6a).

Monedhë

Bronz, farkëtim; dimensionet 1,7 x 0,2 cm; Para hyrjes në bazilikën intra-muros, Sektori II/ Kv: BI/1.o.s.; Muzeu i Polimles – Berane

Constantin I (306-337), (T.II/4,4a), (Popović, 1991: 60, 117)

Monedhë

Bronz, farkëtim; dimensionet 1,8 x 0,2 cm; Para hyrjes në bazilikën intra-muros, Sektori II/ Kv: BI/3.o.s.; Muzeu i Polimles – Berane

Valens (364 – 378) (T. II/5,5a)

Thikë

Hekur, farkëtim; gjatësia 9,8 cm, gjerësia më e madhe e tehut 1,3 cm, trashësia 0,4 cm; në anën e jashtme të portës jugore të bazilikës intra-muros, Sektori III/ Kv. C1/2.o.s.;

Muzeu i Polimles – Berane

Datohet nga shekulli IV deri në shekullin VI

Thikë hekuri, pak e kthyer, me një teh dhe gjemb (T. II/7). Gjetje e zakonshme në fortifikatat e antikitetit të vonë dhe bizantit të hershëm. Analogjitë më të përafërta janë thikat e zbuluara në lokalitetin Ras-Pazarishte (Ras-Pazarište)

afër Novi Pazarit dhe në Vrsenicë (Vrsenica) afër Sjenicës (Sjenica).

Analogjitë: Popović, 1999:113,114, sl. 60/1,8; Popović i Bikić, 2009: 83, al. 58/1,3.

Shigjetëza

Hekur, farkëtim; gjatësia 6,8 cm, gjerësia e thumbit 0,9 cm; bazilika extra-muros, Sektori III / Kv. GII/2.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet nga fundi i shekullit VI dhe fillimi i shekullit VII

Shigjetëza prej hekuri, me tre tehe (T. II/8). Ekzemplarë i ngjashëm rrjedh nga Jelica.

Analogjitë: Milinković, 2010: 85-86, sl. 75; Milinković i Špehar, 2014: 154, kat.br. 180.

Llambë

Xham, fryrje e lirë; gjatësia e ruajtur 5,2 cm, lartësia e ruajtur 1,1 cm; para bazilikës extra-muros, Sektori I / Kv. E IV/2.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane

Datohet nga shekulli V, më shpesh në shekullin VI

Fragment i një llambe, me qark të profiluar në formë tuba, të punuar me teknikën e fryrjes së lirë, me xham ngjyrë gjelbër ulliri (Pl. II / 9). Llamba të ngjashme u gjetën në fortifikatën nga antikiteti i vonë në Vrsenicë (Vrsenica) afër Sjenicës, në lokalitetin Ras-Pazarishte (Ras -Pazarište) afër Novi Pazarit. Përveç vendeve të lartpërmendura, fragmentet e llambave të njëjtave u gjetën në lokalitetin Zlatni Kamen, që gjendet në jug të Novi Pazarit. Lidhen kryesisht me objektet sakrale (Popović, 1999: 108).

Analogjitë: Popović i Bikić, 2009: 146, sl. 52/18; Popović, 1999: 108, sl. 57/13; Ivanišević, 1990: 14-15, sl.4.

Llambë

Xham, fryrje e lirë, shkrirje: gjatësia e ruajtur e qarkut 8,5 cm, lartësia e ruajtur 1,5 cm, diametri i skajit në formë tube 0,4 cm; në anën jugore të bazilikës extra-muros. Sektori I / Kv. F II/3.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane

Datohet në shekullin V, megjithëse është më e pranishme në shtresat e shekullit VI

Qarku i llambës prej xhami i njëjtë me llambën që e përshkruam më herët. Nëpër skajin e trashuar kalojnë dorëzat prej xhami ose grremçat që shërbejnë për varjen e llambës (T. II/10). Është punuar me teknikën e fryrjes së lirë, me xham ngjyrë gjelbër të çeltë.

Llambë

Xham, shkrirje; lartësia 2,5 cm, trashësia 0,6 cm; bazilika extra-muros, Sektori I / Kv. FIII – Podnica; Muzeu i Polimles – Berane

Datohet nga shekulli V, megjithëse është më e pranishme në shtresat e shekullit VI

Dorëza e fragmentuar e llambës së punuar nga xhami ngjyrë gjelbër ulliri (T. III/1). Gjetje e ngjashme rrjedh nga lokaliteti Ras – Pazarishte (Ras-Pazarište) afër Novi Pazarit (Popović, 1999: 108).

Analogjitë: Popović i Bikić, 2009: 146, sl. 52/18; Popović, 1999: 108, sl. 57/13; Ivanišević, 1990: 14-15, sl.4.

Enë xhami

Xham, fryrje e lirë; lartësia 4 cm, diametri i skajit 6,6 cm; diametri i recipientit 5 cm; në anën e jashtme të portës jugore të bazilikës intra-muros, Sektori III / Kv. GI/3.os; Muzeu i Polimles në Berane

E datojmë në fundin e shekullit VI dhe gjysmën e parë të shekullit VII

Enë xhami me recipient pak të rrumbullakosur dhe me qark gjerësisht të shtrirë dhe të trashuar (T. III/6). Është punuar me teknikën e fryrjes së lirë, me xham të gjelbër të çelët.

Analogjitë: Stamenković, 2015: 29.

Mortarium

Gur i trashë, gdhendje, lustrim; lartësia 13 cm, diametri i çeljes 19 cm; protezisi i bazilikës intra-muros, Sektori III / Kv. CII / 2.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet në fundin e shekullit VI dhe fillimin e shekullit VII.

Mortariumi, i punuar nga guri ranor ngjyrë gri, me granulim më të madh (Pl. III / 3). Recipienti është në formë konike, i lustruar nga brenda, me sipërfaqe të vrazhda. Në lartësinë e qarkut, nga jashtë, janë vendosur katër dorëza me prerje

gjysmërrethore përballë njëra tjetrës. Analogjitë më të afërta i kemi në Tumbarice dhe Gradina Jelica.

Analogjitë: Milinkovic, 1986: 53, T. VII; Milinković, 2010: 190, sl. 259; Milinković, 2017: 151, kat br. 218

Byzylyk

Bronz, farkëtim; diametri 6,4 cm; nekropoli jugor, Sektori II / Varri nr. 2; Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet në shekujt IV-V

Byzylyk bronzi, me skaje të hapura dhe të trashura, të punuar në formën e kokave të stilizuara të gjarprit. Trupi i byzylykut me prerje të cekët gjysmërrethore (T. III / 4). Ekzemplarë të ngjashëm rrjedhin nga nekropoli i Dukleas antike.

Analogjitë: Cermanović-Kuzmanović, Velimirović - Žižić, Srejšević, 1975: 233, sl.131a).

Unazë

Bronz, farkëtim; diametri 2 cm; nekropoli jugor, Sektori II / Varri nr. 2; Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet në shekujt IV-V (Špehar, 2010: 68, me literaturë më të vjetër).

Unazë bronzi, e punuar me fletë në formë shiriti, me kokë katrore të përforcuar pas punimit, e zbukuruar me dy rrathë koncentrikë dhe një pikë në mes (Pl. III / 5). Një unazë e ngjashme me kokë në formë pllake me prerje katrore u gjet në vendin Ras – Pazarište (Ras - Pazarište) pranë Novi Pazarit dhe në Diana në limesin danubian.

Analogjitë: Popović, 1999: 110, sl. 58/13; Špehar, 2010: 68, kat br. 139.

Rruazë

Gur; lartësia 1,3 cm, diametri 3,1 cm; nekropoli jugor, Sektori II / Varri nr. 2; Muzeu i Polimles në Berane

Ky lloj zbulimi datohet në shekullin IV.

Rruazë me formë gjysmësferike, i punuar nga guri i errët (Pl. III / 6,6a). Sipërfaqja e poshtme është zbukuruara me pesë vija paralele të gërvishura gjerësisht, ndërsa kalota është zbukuruar me katër vija paralele të gërvishura, me dy në pjesën e poshtme dhe dy në pjesën e sipërme. Një ekzem-

plar pothuajse identik u gjet në Tupi krsh (Tupi krš) afër Tutinit, kurse të ngjashëm u gjetën në Zlostup afër Ostrovicës (Ostrovica), Gamzigrad dhe në Dijanë (Dijana).

Analogjitë: Milinkovic, 1985: 52, T. II / 2; Milinković, 1982: 132; Srejšević, Lalović and Janković, 1983: kat br. 221; Špehar, 2010: 111, T. XXX / 525.

Vath

Argjend, farkëtim, lakim; dimensionet: diametri 1.6 cm; nekropoli jugor, Sektori II / Varri nr. 1; Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet në shekullin IV

Vath i punuar me tel të hollë prej argjendi, me syth për mbyllje (T. III / 7). Në pjesën e poshtme është një pjesëz e varur, e formuar nga një mbështjellje teli dhe një perlë më e vogël në fund të pjesëzës së varur, e cila mungon. Datimi është bërë duke u bazuar në gjetjet tjera.

Analogjitë: Cermanović – Kuzmanović i saradnici: 234, grob 51.

Unazë

Bronz, farkëtim, gravurë, shpim; përmasat: diametri 2 cm, trashësia 0,1 cm; ndërtesa përgjatë bedenit perëndimor, Sonda V / 1.o.s.

Datohet në shekullin VI.

Një unazë e bërë nga një shirit bronzi, që shtrihet drejt pllakës që mungon (T. III / 8). Trupi i unazës është i dekoruar me vija të gërvishura, si dhe me shpime. Në mes të shiritit janë stampuar një sërë rrathësh me një pikë.

Unazë

Bronz, farkëtim ;përmasat: diametri 2 cm, trashësia 0,1 cm; Hyrja në akropol; Muzeu i Polimles në Berane

Datohet në Shekujt V – VII

Unazë prej bronzi me hallkë me prerje rrethore e cila është e trashuar dhe zgjeruar në pjesën e sipërme, duke formuar kështu kokën me prerje elipsoide. Ky tip i unazës është i ngjashëm me atë të gjetur në Gradine pranë Jelicës (Jelica).

Datimi: Милинковић, 2014, 100, kat.br. 33.

Gur (i peshores)

Bronz, farkëtim, gërvishtje; dimensionet: 2 X 1,9 X 0,5 cm; Mu përpara hyrjes në bazilikën intra-muros, gjetje e rastësishme; Muzeu i Polimles në Berane

Datohet në shekujt IV - VI.

Gur (i peshores) prej bronzi, me formë katrore dhe qark të kthyer. Në pjesën e sipërme është gërvishtur thellë numri romak XIII.

Pjata (e peshores)

Bronz, farkëtim, prerje, shpim; dimensionet: 4,9 x 0,1 cm; para bazilikës intra-muros, Sektori III / Kv. BI / Pov.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet në shekujt IV - V.

Pjatë e peshores, prej bronzi, në formë rrethore me vrima të shpuara për varjen e zinxhirit.

Peshorja

Bronz, farkëtim, lakim, shpim; Përmasat: 15,7 x 0,3 cm; para bazilikës intra-muros, Sektori II / Kv. AI / 3.o.s.; Muzeu i Polimles në Berane.

Datohet në shekujt IV - VI.

Peshorja e rrafshët për matjen e objekteve të vogla, respektivisht metaleve të çmuara. Peshore të ngjashme janë gjetur në lokacionin Ras - Pazarište në Novi Pazar. Ky lloj i peshores është gjetur shpesh në vendet e antikitetit të vonë.

Analogjitë: Popović, 1999: 116, kat br. 160, sl. 67; Bavant, 1990: 244-245, pl.XLIV / 300; Ljubenova, 1981: 190-191, sl. 143)

PËRFUNDIM

Bazuar në rezultatet e gërmimit, mund të supozojmë se Samogradi personifikon një qendër të rëndësishme shpirtërore dhe administrative në luginën e Brzavës (*Brzava*), e tërthorazi edhe në luginën e Limit (*Lim*). Përmes kësaj lugine kalonin komunikime të rëndësishme në periudhën antike (Bojanovski, 1987: 138-141), kurse në mesjetë atypari kalonte rruga e Zetës (*Via de Zenta*), e quajtur popullorçe "Xhade latine" (*latinska džada*) (Jiricek, 1951: 108-109). Më vonë, mbi të njëjtën trase kalonin rrugët karvanike mesjetare për në Bihor, Ras dhe më tej në Pomoravlje (*Pomoravlje*) (Garašanin, 1967: 236-237; Dinić, 1937: 121-123).

Këto rrugë janë në lidhje të drejtpërdrejtë me eksploatimin e pasurisë minerale të Polimles (*Polimlje*) dhe, mbi të gjitha, të malit të Bjellasicës (*Bjelasica*). Mund të supozohet se xehetaria ishte kategoria ekonomike bazë e kësaj zone gjatë antikitetit (Душанић, 1980: 23-24) dhe se pozita e aglomerateve urbane, fortifikatave dhe komunikimeve kushtëzohej nga eksploatimi dhe shpërndarja, e ndoshta edhe përpunimi i xehes. Në Bjellasicë, në afërsi të Samogradit dhe në kanionin e lumit Brzava (*Brzavska rijeka*), ka një sërë toponimesh indikative që tregojnë për veprimtarinë e vjetër xehetare: Vignjište, Olovište, Rupe, Rudine, Rudni potok, Ognjišta, Crljevine, Srebrenica, e të tjerë (Губеринић, 1985). Bëhet fjalë për gjurmë pak të dukshme, por të dallueshme të hapësirave të xehoreve dhe korridoreve të shembura. Për eksploatimin e mundshëm të xeheve tregon tërthorazi gjetja e peshoreve të vogla për matjen e metaleve të çmuara.

BIBLIOGRAFIA

Basler, Đ. (1972). *Arhitektura kasnoantičkog doba u Bosni i Hercegovini*, Sarajevo.

Bavant, B. (1999). *Les petits objets*, in: Caričin grad II, Rim – Beograd, 191 – 257.

Brukner, O. (1981). *Rimska keramika u Jugoslovenskom dijelu provincije Donje Panonije*, Beograd.

Bojanovski, I. (1987). *Prilozi za topografiju rimskih i predrimskih komunikacija i naselja u rimskoj provinciji Dalmaciji V*, Godišnjak CBI, XXV (23), Sarajevo, 138-141.

Cermanović - Kuzmanović, A. (1975). *Pregled i tipologija keramike u jugoistočnom dijelu rimske provincije Dalmacije*, Arheološki vesnik XXVI, Qubqana, 68.

Cvjetičanin, T. (2006). *Kasnoantička gledosana keramika*, Arheološke monografije 19, Beograd.

Гарашанин, М. (1983). *Праисторија на тлу СР Србије*, Beograd, 404.

Губеринић, Р. (1985). *Стари трг и рудник Брсково, Трг Брсково на Лиму а не на Тари*. Иванград.

Ivanišević, V. (1990). *Kasnoantičko utvrđenje na Zlatnom Kršu kod Novog Pazara*, NPZ 14, Novi Pazar.

Јиричек, К. (1951). *Трговачки друмови и рудници Србије и Босне у средњем веку*. Сарајево, 108 – 109.

Динић, М. (1973). *Дубровачка средњевековна караванска трговина*, ЈИЧ III, Beograd, 121-123.

Кондић, В., Поповић, В. (1977). *Царичин град – Утврђено насеље у Илирику*, Beograd.

Гарашанин, Д., Гарашанин, М. (1967). *Историја Црне Горе I*, Титоград, 236 – 237.

Љубенова, В. (1981). *Selišteto ot rimskata i rannovizantiiskata epoha*, in: Pernik I, Sofija, 143 -164.

Лутовац, М. (1973). *Стари градови и утврђења у Полимљу*, Гласник српског географског друштва LIII -1, Beograd.

- Лутовац, П. (2009). *Bjelasica i Komovi – Nova arheološka istraživanja*, Токови. 1/ Беране, 245-256.
- Мијовић, П., Ковачевић, П. (1975) Градови и утврђења у Црној Гори, Београд – Улцињ.
- Милинковић, М. (2017). Градина на Јелици – Рановизантијски утврђени центар у Илирику. Београд – Чачак.
- Милинковић, М., Шпехар, П. (2014). Градина на Јелици – Тридесет година археолошких истраживања. Чачак.
- Милинковић, М. (2010). Градина на јелици – Рановизантијски град и средњевековно насеље. Београд.
- Милинковић, М. (1982). Касноантичко утврђење у Островици и Шароњама код Тутина, NPZ 6, Novi Pazar, 131-140.
- Милинковић, М. (1985). Рановизантијско утврђење на Тупом кршу и околна утврђења у тутинској област, NPZ 9, Novi Pazar, 47-54.
- Мирковић, М. (1978). *Antistes Stefanus и грађевинска делатност Јустинијановог времена у Полимљу*, Зборник византолошког института XVIII, Beograd, 1-8.
- Мирник, I. A. (1981). *Coin Hards in Yugoslavia*, Bar Inte. Ser. 95, Oxford.
- Мркобрад, Д., Јиванивић, А. (1989). *Самоград – Археолошка истраживања*, НПЗ 13, Нови Пазар, 31 - 46.
- Мркобрад, Д., Лутовац, П. (1990). *Резултати истраживања вишеслојног утврђења Самоград у Полимљу*, Гласник српског археолошког друштва 6, Београд, 135-139.
- Мркобрад, Д. (1980). *Arheološki nalazi seobe naroda u Jugoslaviji*, Beograd.
- Николајевић, И. (1976). Сеоски дани С. Вукослављевића 3, Пријепоље.
- Поповић, М. (1983). *Antičko utvrđenje na Šarskom Kršu kod Duge Poljane*, NPZ 7, 8-14.
- Поповић, М. (1999). *Tvrđava Ras*, Beograd.
- Поповић, М., Бикић, В. (2009). *Vrsenice – kasnoantičko i srpsko ranosrednjovekovno utvrđenje*, Beograd.
- Šagadin, M. (1979). *Antične pasne spone in garniture v Sloveniji*, AV XXX, 294-338.
- Срејовић, Д., Лаловић, А., Јанковић, Ђ. (1983). *Гамзиград – касноантички царски дворца. Галерија српске академије наука и уметности*. Београд.